

V E N D I M
Nr.144, datë 19.4.2002

**PËR SHITJEN E MATERIALEVE TË KRIJUARA NGA NXJERRJA JASHTË
PËRDORIMIT E DISA ARMËVE TË KËMBËSORISË, NË ADMINISTRIM TË FORCAVE
TË ARMATOSURA**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 7, të nenit 14, të ligjit nr.8671, datë 26.10.2001, "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit dhe drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 23, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë të veprimtarive priate, të pavarura dhe privatizimit", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes t'i shesë, pa andkand, shoqërisë "KURUM, Internacional", shpk, sasinë prej 1528,9 tonësh të materialeve të krijuara nga nxjerrja jashtë përdorimit e disa armëve të këmbësorisë, në administrim të Forcave të Armatosura.

2.Çmimi i shitjes së këtyre materialeve të miratohet nga ministri i Mbrojtjes.

3.Shuma e përfutur nga shitja e këtyre materialeve të përdoret sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin nr.424, datë 9.7.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore".

4.Ngarkohet ministri i Mbrojtjes të nxjerrë urdhërat dhe udhëzimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

ANEKSI A

Çmimi i shitjes së Skrapit të vendndodhjes

Repartet	Prefektura	Sasia në ton	Transporti	Çmimi lekë/kg (pa TVSH)
Rep.usht.8800	Tiranë	25	Kurum sh.p.k.	4.5
Rep.usht.3400	Tiranë	868	Kurum sh.p.k.	4.5
Rep.usht.5011	Tiranë	46	Kurum sh.p.k.	4.5
Rep.usht.2001	Durrës	60	Kurum sh.p.k.	4.5
Rep.usht.5012	Elbasan	250	Kurum sh.p.k.	4.5
Rep.usht.1100	Shkodër	70	Kurum sh.p.k.	3.5
Rep.usht.2200	Kukës	19	Kurum sh.p.k.	3.5
Rep.usht.3300	Burrel	30	Kurum sh.p.k.	3.5
Rep.usht.4400	Korçë	70	Kurum sh.p.k.	3.5
Rep.usht.5500	Gjirokastër	30	Kurum sh.p.k.	3.5
Rep.usht.6600	Fier	40	Kurum sh.p.k.	3.5
Rep.usht.5014	Rrëshen	20	Kurum sh.p.k.	3.5

	ndry.këmbësorie												
	SHUMA	748		104	19	23	81	37	108	39	29	56	19

Tabela me sasitë e armëve të dala jashtë përdorimit dhe sasia e skrapit të përfituar